LIGJ
Nr.7706, datë 13.5.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7559, DATE 22.4.1992 "PËR BANKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neni 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7559, datë 22.4.1992, "Për Bankën e Shqipërisë" neni 36 ndryshohet si vijon;

"Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë është leku.

Banka e Shqipërisë përcakton formën, masat, peshën, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartmonedhave e monedhave metalike shqiptare, të cilat kanë kurs ligjor, si dhe të monedhave e kartmonedhave që do të shtypen për qëllime numizmatike".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.539, datë 18.5.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.